



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 08.08.2023
Ref. KM-300/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

VENDIM

Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve – Feniks 069 EW i prodhuesit “Pestila Spolka z organiczna odpowiedzialnoscia”, Poloni nga përfaqësuesi i saj “Agronomi Group” Shpk, Suhareke.

2. LLOJI I PRODUKTIT: Herbicid

3. PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE: Fenoxaprop-p-ethyl.....69g ose kg/l.

4. PËRDORIMI:

Feniks 069 EW është një herbicid, në formën e një emulsioni (vaj në ujë), i dedikuar për luftimin e barojave të këqija në elb pranveror dhe grurë dimërore po ashtu është një herbicid me veprim sistemik, bimët shume shpejte e thithin përmes gjethes dhe e shpërndajnë ne pjesët tjera.

Elbi pranveror, barojat e këqija te ndjeshme: tërshëra e egër(Avefa-Avena fatua),përdorimi i produktit me përzierje MCPA Plus 340 SL. Barërat e këqija te ndjeshme: Apere kalliere(Apera spica –venti),Ngjites rrodhe(Galium aparine), Muhar(Echinocoa crus-galli),Minueri i bardhe(Chenopodium album),Kamomile maritim(Matricaria inodorum),Fallopia dredhëz(Fallopia convolvulus),Veronike arash (Veronica arvensis), Stellare e ndermjrtme (Stellaria media).Barerat e keqija mesateraishte te ndjeshme ,Manushaqe arash (Viola arvensis).

Elbi pranveror, gruri dimëror, zbatohet nga faza e 2 gjetheve te zhvilluara plotësisht ne fazën e pare te gjurit(bbch 22-33).Doza maksimale/ ne mënyrë individuale e rekomanduar:1.0l/ha

Numri maksimal i aplikimeve vjetore:1 here.

Sasia e rekomanduar e ujit:200-300l/ha. Spërkatja e rekomanduar: madhësia mesatare e pikëve.

5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:

0.5L; 1L;5L; 10L; 20L; 220L;

6. VËREJTJE:

Mos ndoteni ujin me produktin ose enën e tij, mos e pastroni pajisjet e aplikimit pranë ujit sipërfaqësor, shmangni kontaminimin përmes kanaleve të kullimit nga fermat dhe rrugët. Për të mbrojtur organizmat ujore, respektojeni një zonë tampon të papërpunuar prej 1m në sipërfaqen e trupave ujore, për të mbrojtur bimët jo të synuara, respektojeni një zonë tampon të papërpunuar prej 5 m në toke jo bujqësorë.

7. KARENCA:

Nuk ka.



8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:

GHS07- ngacmues, irritues (cat 2 ose 3)



GHS09- paralajmërim (cat 1)-i rrezikshëm për ambient.

9. VENDI I SHITJËS: Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

10. Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar në Databazën e Pesticideve të BE-se/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Faton Peci

Ministër

Vendimi i dërgohet:

- Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;
- Shërbimi kufitar fitosanitar;
- Inspektorët fitosanitar AUV;
- Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Arkivit.